



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-060

Prishtinë, më 6 mars 2019, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 6 MARS 2019**

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Elmi Reçica, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha

**Nga EUSR-ja:** Blerta Bejtullahu dhe

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

#### **1. Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, për seancë të jashtëzakonshme**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 38 të Rregullores së Kuvendit, ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit, më 7 mars 2019, me këtë rend dite: *1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe 2. Shqyrtimi i Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.*

Lidhur me kërkesën e lartshënuar të kryeministrit, z. Haradinaj, diskutuan: Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate; Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Avdullah Hoti, kryetar i GP të LDK-së; Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit dhe deputeti Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të enjten, më 7 mars 2019, në orën 09:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë,
2. Shqyrtimi i Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*